



Termet e referencës

Grupi Punues për Çështje Ligjore

QËLLIMI

Ky dokument përmbledhë përshkrimin e punës për Grupin Punues për Çështje Ligjore për përpilimin e Strategjisë për Digjitalizim të Republikës së Kosovës (tash e tutje Strategjia) me qëllim të arritjes së objektivit Nr. 1 të KPM-së për vitin 2010.

Grupi Punues për çështje ligjore është themeluar me vendimin Nr. 0901/0045/KKPM/dd të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media për të hartuar pjesën ligjore të strategjisë.

FUNKSIONI

Funksioni i Grupit Punues për Çështje Ligjore është të hartojë pjesën ligjore të Strategjisë, të merr pjesë në takime me publikun për diskutimin e draftit, të bashkëpunojë me katër grupet tjera punuese për strategjinë e digjitalizimit dhe të jap kontributin e tyre në finalizimin e Strategjisë.

Funksioni i Grupit punues skadon me finalizimin e Strategjisë.

PËRBËRJA E GRUPIT PUNUES:

Grupi punues për Çështje Ligjore përbëhet nga këta anëtarë:

Emri	Pozita
1. Ramë Bajraktari	Kryesues, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
2. Filloreta Bytyçi	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
3. Latif Xhemaili	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
4. Liridon Dalipi	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
5. Niman Racaj	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
6. Arbnore Sadikaj	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
7. Arta Zejnullahu	Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)

8. Bahri Hyseni	Komisioni për Legjislacion, Kuvendi i Kosovës
9. Elvana Prekazi	RTK
10. Lekë Zherka	KTV
11. Ekrem Kelmendi	TV 21
12. Visar Hoti	AMPEK / Mediat Lokale
13. Mifail Bytyçi	AMPEK / Mediat Lokale
14. Besim Kajtazi	Drejtor i Zyrës Ligjore ZKM
15. Synavere Rysha	Komisioni për Media i Kuvendit
16. Shyqri Hyseni	MEF
17. Nenad Milenković	TV Puls/ Mediat lokale serbe

OBLIGIMET E ANËTARËVE TË GRUPIT

Të gjithë anëtarët e grupit duhet:

- T'i respektojnë termat e referencës së Grupit;
- Të pranojnë një kopje dhe të lexojnë ligjin për KPM-në dhe materialet tjera të prodhuara nga aktivitetet e KPM-së për digjitalizim dhe materialet tjera relevante që kanë të bëjnë me punën e përgjithshme të KPM-së.
- Të deklarojnë konflikt (eventual) të interesit në fillim të takimit.
- Të kenë pjesëmarrje aktive në të gjitha takimet, duke ju përgjigjur ftesës së dërguar përmes Sekretariatit. *Në raste të jashtëzakonshme kur anëtari nuk do të ketë mundësi të marrë pjesë në takim e informon Kryesuesin e Grupit Punues përmes Sekretariatit për zëvendësim.*
- Të japin kontribut aktiv në grup punues duke dhënë komente rreth përmbajtjes ligjore të Strategjisë dhe mbi çështjet që duhet adresuar
- Të ndihmojnë në përpilimin e dokumentit final.

EKSPERTIZA E BRENDSHME, PËRFAQËSUES TË INSTITUCIONEVE DHE PALËVE TJERA ME INTERES - DETYRAT SPECIFIKE

Përveç obligimeve të cekura më lartë ekspertët e vendit si dhe përfaqësuesit e organizatave/institucioneve dhe palëve tjera me interes kanë për obligim:

- Të japin ekspertizën e tyre relevante gjatë përpilimit dhe finalizimit të strategjisë;
- Të paraqesin perspektivën e institucioneve të tyre në lidhje me planin strategjik dhe procesin e digjitalizimit në përgjithësi;
- Të japin informata për grupin punues duke ndihmuar përshtatjen e planit strategjik në sferën e fushë veprimtarisë së tyre dhe interesit të përbashkët në këtë aspekt.

EKSPERTIZA E JASHTME

Grupi Punues për Çështje Ligjore ka të drejtë që kohë pas kohe të kërkojë ndihmë nga ekspertë të jashtëm për çështje të caktuara për të cilat mungon ekspertiza brenda grupit punues në Kosovë. Në këtë rast, Grupi Punues do t'ia paraqesë këtë kërkesë Kryesuesit përmes Sekretariatit.

Ekspertët e jashtëm do të angazhohen në bazë të kriterëve specifike të përcaktuara nga KPM.

REKOMANDIMET PËR VENDIME

GP i propozon Këshillit të KPM-së rekomandimet e veta për marrjen e vendimeve për çështje të rëndësisë së veçantë të cilat mund të dalin gjatë procesit të hartimit të pjesës ligjore të strategjisë.

GP harmonizon draftin e pjesës ligjore të strategjisë duke evidentuar edhe kundërshtimet dhe të tilla ia përcjell Këshillit të KPM-së për shqyrtim dhe miratim.

TAKIMET

Grupi Punues për Çështje Ligjore do të takohet të paktën 1 herë në muaj.

Agjenda e takimeve dhe dokumentet tjera që kanë të bëjnë me punën e Grupit Punues për Çështje Ligjore do t'i dërgohen Grupit disa ditë para takimit që t'u jepet anëtarëve mundësi të familjarizohen me materialet.

Pas çdo takimi do të hartohet procesverbali i cili do të ratifikohet në takimin e radhës. Pas ratifikimit, procesverbali nënshkruhet nga Kryesuesi i Grupit Punues.